



Periodiku AMF

I. Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2007

Në seancën plenare të datës 5 Maj 2008, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për vitin 2007.

Rezoluta e Kuvendit vlerëson veprimtarinë e kryer nga AMF gjatë vitit 2007

Vijon në faqen 2

II. Prezantim mbi tregjet financiare jo - bankare në forumin e Crans Montanës (15 Maj 2008)

Pas dy takimeve vjetore të suksesshme në Tiranë, Forumi i Crans Montanës u mbledh sërish në datat 15 – 17 Maj 2008, nën patronazhin e Kryeministrit Berisha, për të diskutuar mbi çështje strategjike të zhvillimit të sektorit financiar, energjetik dhe probleme të sigurisë globale në nivel rajonal.

Vijon në faqen 4

III. Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

III.1 “Gjeografia e Sigurimeve 2007”, publikim i ri i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

“Gjeografia e sigurimeve 2007” është një publikim statistikor, i cili realizohet për herë të parë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Në thelb të këtij publikimi përfshihet informacioni mbi shpërndarjen e primeve dhe produkteve të sigurimit sipas prefekturave

Vijon në faqen 7

III.2 Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar-prill 2008

Në periudhën janar – prill 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 2,054,344 mijë lekë, përkundrajt 1,790,578 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007.

Vijon në faqen 10

IV. Ngjarje dhe zhvillime të tjera

IV.1 Takim i Kryetares së AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, me përfaqësuesit e lartë të Autoritetit Qëndror Bankar të Kosovës

Në datën 6 Maj 2008, një delegacion i nivelit të lartë të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës (AOBK), i përbërë nga Z. Gazmend Luboteni, Kryetar i Bordit, Z. Hashim Rexhepi, Drejtor i Përgjithshëm dhe Z. Agron Dida, Inspektor i Përgjithshëm, pati një takim pune me Zj. Elisabeta Gjoni, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF)

Vijon në faqen 11

IV.2 Mbi pjesëmarrjen në konferencën e 33-të vjetore të IOSCO-s

Gjatë periudhës 26-29 maj 2008, në Paris, Francë, u zhvillua konferenca e 33-të vjetore e IOSCO-s. Në të morën pjesë rreth 750 delegatë nga rregullatorë të letrave me vlerë nga mbarë bota dhe komuniteti ndërkombëtar financiar. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua nga Kryetarja, Zj. Elisabeta Gjoni dhe Nënkryetari, Z. Keler Gjika.

Vijon në faqen 11

IV.3 Organizohet misioni TAIEX për kuadrin ligjor të pensioneve private vullnetare

Në datat 5 – 7 maj 2008, në ambientet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, u organizua misioni i ekspertëve TAIEX, përfaqësuar nga z. Slawomir Solarz, ekspert me përvojë të gjatë në fushën e pensioneve, aktualisht Këshilltar i Kryetarit pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë

Vijon në faqen 13

IV.4 Pjesëmarrje në seminarin “Vështrim i përgjithshëm i çështjeve të sektorit financiar”

Në datat 28 prill - 2 maj, në Washington DC, Banka Botërore (WB) organizoi seminarin me temë “Vështrim i përgjithshëm i çështjeve të sektorit financiar”

Vijon në faqen 13

Në këtë numër:

Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2007

2

Prezantim mbi tregjet financiare jo - bankare në forumin e Crans Montanës (15 Maj 2008)

4

“Gjeografia e Sigurimeve 2007”, publikim i ri i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

7

Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar-prill 2008

10

Takim i Kryetares së AMF-së, Zj Elisabeta Gjoni, me përfaqësuesit e lartë të Autoritetit Qëndror Bankar të Kosovës

11

Mbi pjesëmarrjen në konferencën e 33-të vjetore të IOSCO-s

11

Organizohet misioni TAIEX për kuadrin ligjor të pensioneve private vullnetare

13

Pjesëmarrje në seminarin “Vështrim i përgjithshëm i çështjeve të sektorit financiar”

13

Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2007

Në seancën plenare të datës 5 Maj 2008, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për vitin 2007.

Rezoluta e Kuvendit vlerëson veprimtarinë e kryer nga AMF gjatë vitit 2007 në drejtimet e mëposhtme:

- përmirësimin e kuadrit ligjor për rregullimin dhe zgjerimin e tregut të sigurimeve, veçanërisht atyre të detyrueshme, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve, me qëllim nxitjen e produkteve të sigurimit të përgjegjësive në sektorët e karburanteve, ndërtimit, minierave, koncensioneve dhe hotelerisë, mbështetur në kërkesat e tregut dhe në detyrimet që rrjedhin në kuadër të Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian;
- përmbushjen me sukses të procesit të zgjerimit të prezencës së kapitalit të huaj në shoqëritë e sigurimeve gjatë vitit 2007;
- mbikëqyrjen e tregjeve financiare jo-bankare dhe të performancës së subjekteve që veprojnë në këto tregje, nëpërmjet aplikimit të modeleve me bazë rrisht dhe të një sistemi të strukturuar të analizës financiare, duke synuar identifikimin, parandalimin dhe reduktimin e shkallës së rreziqeve që kërcënojnë stabilitetin e tregut dhe interesat e konsumatorëve;
- përgatitjen e akteve nënligjore për investimin e provigjoneve, praktikave të trajtimit dhe vlerësimit të dëmeve në sigurime, marrëveshjet e risigurimit, veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime;
- rritjen e shkallës së transparencës të

operatorëve në treg nëpërmjet përmirësimit të sistemit të tyre të raportimit;

- vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët dhe institucionet në vend, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në tërheqjen e praktikave më të mira;
- rritjen e shkallës së informimit të konsumatorëve për produktet e ofruara nga shoqëritë që ushtrojnë veprimtari në këto tregje, nëpërmjet mbështetjes nga një sistem elektronik i avancuar komunikimi;
- përmirësimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale nëpërmjet zhvillimit të një strukture efektive, politikave të përzgjedhjes së burimeve njerëzore dhe trajnimit të vazhdueshëm të stafit.

Nëpërmjet Rezolutës, Kuvendi i Shqipërisë kërkon që, midis të tjerave, AMF gjatë vitit 2008 të përqëndrojë punën në drejtimet e mëposhtme:

- plotësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e nënligjor të institucionit, në përputhje me kërkesat e tregjeve, praktikave të vendeve të tjera dhe direktivat e Bashkimit Europian, me synim zgjerimin e mëtejshëm të tregjeve të sigurimeve dhe skemave private të pensioneve;
- rritjen e masës dhe cilësisë së mbikëqyrjes së tregjeve financiare jo-bankare, për të zvogëluar dhe parandaluar rreziqet ndaj stabilitetit të tyre;
- bashkëpunimin me operatorët e tregjeve financiare jo-bankare për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe marrjen e masave organizative, me synim përmirësimin e raportit dëme/prime, uljen e shpenzimeve administrative dhe rritjen e efektivitetit të kapitalit;
- bashkëpunimin me Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Konkurrencës për garantimin e një tregu të lirë, konkurrues e transparent, në mbrojtje të

interesave të klientëve;

- hartimin dhe miratimin e legjislacionit të ri, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare për sigurimin e detyrueshëm dhe për pensionet private suplementare;
- fillimin e punës për hartimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit për mbrojtjen nga katastrofat;

- rritjen e bashkëpunimit me biznesin dhe përmirësimin e legjislacionit për të zgjeruar gamën e produkteve të siguruar prej tij, veçanërisht të produkteve të sigurimit vullnetar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT
TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2007**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 103 të Rregullores së Kuvendit dhe me nenin 28 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare", pasi u njoh me Raportin për Veprimtarinë e Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare për vitin 2006, si dhe me raportin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për vlerësimin e veprimtarisë së këtij institucioni, **konstaton se:**

- veprimtaria e Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare";
- Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare ka zbatuar rekomandimet e Kuvendit, të shprehura në rezolutën "Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare për vitin 2006".

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare në drejtim të:

- përmirësimin të kuadrit ligjor për rregullimin dhe zgjerimin e tregut të sigurimeve, veçanërisht atyre të detyrueshme, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore dhe rregulloreve, me qëllim nxitjen e produkteve të sigurimit e të përgjegjësisë në sektorët e karburanteve, ndërtimit, minierave, koncesioneve dhe hotelerisë, mbështetur në kërkesat e tregut dhe në detyrimet që rrjedhin në kuadër të Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian;
- përmbushjes me sukses të procesit të zgjerimit të prezencës së kapitalit të huaj në shoqëritë e sigurimeve gjatë vitit 2007;
- mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare dhe të performancës së subjekteve që veprojnë në këto tregje nëpërmjet aplikimit të modeleve me bazë risku dhe të një sistemi të strukturuar të analizës financiare, duke synuar identifikimin, parandalimin dhe

reduktimin e shkallës së rreziqeve që kërcënojnë stabilitetin e tregut dhe interesat e konsumatorëve;

- përgatitjes së akteve nënligjore për investimin e provigjoneve, praktikën e trajtimit dhe vlerësimin të dëmeve në sigurime, marrëveshjet e risigurimit, veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime;
- rritjes së shkallës së transparencës të operatorëve në treg nëpërmjet përmirësimit të sistemit të tyre të raportimit;
- vendosjes së marrëdhënieve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët dhe institucionet në vend, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në tërheqjen e praktikave më të mira;
- rritjes së shkallës së informimit të konsumatorëve për produktet e ofruara nga shoqëritë që ushtrojnë veprimtari në këto tregje, nëpërmjet mbështetjes nga një sistem elektronik i avancuar komunikimi;
- përmirësimit të mëtejshëm të kapaciteteve institucionale, nëpërmjet zhvillimit të një strukture efektive, politikave të përzgjedhjes së burimeve njerëzore dhe trajnimit të vazhdueshëm të stafit.

Kuvendi kërkon që për vitin 2008 Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare, midis të tjerave, të përqendrojë punën edhe në këto drejtime:

- plotësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e nënligjor të institucionit, në përputhje me kërkesat e tregjeve, praktikën e vendeve të tjera dhe direktivat e Bashkimit Europian, me synim zgjerimin e mëtejshëm të tregjeve të sigurimeve dhe skemave private të pensioneve;
- rritjen e masës dhe cilësisë së mbikëqyrjes së tregjeve financiare jobankare për të zvogëluar dhe parandaluar rreziqet ndaj stabilitetit të tyre;
- bashkëpunimin me operatorët e tregjeve financiare jobankare për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe marrjen e masave organizative, me synim përmirësimin e raportit dëme/prime; uljen e shpenzimeve administrative dhe rritjen e efektivitetit të kapitalit;
- bashkëpunimin me Ministrinë e Financave, Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Konkurrencës për garantimin e një tregu të lirë, konkurrues e transparent, në mbrojtje të interesave të klientëve;
- hartimin dhe miratimin e legjislacionit të ri, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare për sigurimin e detyrueshëm dhe për pensionet private suplementare;
- fillimin e punës për hartimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit për mbrojtjen nga katastrofat;
- rritjen e bashkëpunimit me biznesin dhe përmirësimin e legjislacionit për të zgjeruar gamën e produkteve të siguruar prej tij, veçanërisht të produkteve të sigurimit vullnetar.

5 maj 2008

Prezantim mbi tregjet financiare jo - bankare në forumin e Crans Montanës (15 Maj 2008)

Pas dy takimeve vjetore të suksesshme në Tiranë, Forumi i Crans Montanës u mbledh sërish në datat 15 – 17 Maj 2008, nën patronazhin e Kryeministrit Berisha, për të diskutuar mbi çështje strategjike të zhvillimit të sektorit financiar, energjetik dhe probleme të sigurisë globale në nivel rajonal.

Sesioni i parë i këtij Forumi i drejtuar nga Ministri i Financave, Z. Ridvan Bode, trajtoi çështje të zhvillimit të sektorit bankar dhe financiar. Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), pjesëmarrëse në panelin e diskutimeve të këtij sesioni, bëri një përmbledhje të situatës së tregjeve financiare jo – bankare në Shqipëri, me fokus perspektivat e zhvillimit të vrullshëm të tyre brenda një kohe të shkurtër.

Më poshtë do të lexoni të plotë fjalën e mbajtur nga Kryetarja e AMF, Zj. Elisabeta Gjoni, në këtë forum.

Mirëdita zonja dhe zotërinj, miq dhe kolegë!

Kam kënaqësinë të flas në këtë forum prestigjioz stimulues intelektual. Është hera e tretë që ky Forum mbahet në Tiranë dhe mbajtja e një sesioni të veçantë mbi perspektivat e sektorit financiar ka një rëndësi të madhe. Prezantimi im bën një përmbledhje të shkurtër të gjendjes së tregjeve financiare jo – bankare në Shqipëri, me fokus mundësitë e mëdha që ato kanë për t'u zhvilluar vrullshëm brenda një kohe të shkurtër.

I. Sigurimet

Sigurimet do të kenë një zhvillim të madh në vitet në vijim

Viti 2007 ishte një vit i jashtëzakonshëm për tregun e sigurimeve që u rrit dhe u zhvillua në një klimë shumë të favorshme. Rritja e ekonomisë në vend dhe vetë ambienti i stabilizuar i sigurimeve gjetën pasqyrim në fitimet e larta të këtij sektori.

Pavarësisht zhvillimeve pozitive, tregu mbeti i orientuar në sigurimet e detyrueshme motorrike që zunë rreth 65% të të ardhurave nga primet e sigurimit për vitin 2007.

Sigurimet e jetës zënë rreth 7% të totalit të tregut. Penetrimi në sigurime u rrit në vitin 2007: primet për frymë arritën në 20 USD krahasuar me 15 USD në vitin 2006, ndërsa raporti i primeve mbi PBB ishte 0,58% në krahasim me 0,5% në 2006. Gjithsesi, penetrimi i sigurimeve në ekonominë e vendit mbetet në nivele të ulëta po të krahasohet me vendet e tjera të rajonit dhe Europës.

Duhet përmendur që zhvillimi i shpejtë i sektorit bankar, si edhe i investimeve publike në infrastrukturë ka ndikuar në zgjerimin e portofoleve të sigurimit në fushat e pronës dhe ndërtimit.

Nisur nga rritja, zhvillimet dhe ngjarjet e veçanta, viti 2007 mund të konsiderohet si **“Viti i Sigurimeve në Shqipëri”** që i çel rrugën një dekade të tërë të sigurimeve.

- Kapitali minimal i shoqërive të sigurimit u përshtat sipas kërkesave të direktivave Europiane në nivelin 3 milionë Euro, ndërsa më parë ishte rreth 700 mijë Euro. Përshtatshmëria e kapitalit ka një rëndësi jetike në menaxhimin e rrezikut. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare kërkon kapital të përshtatshëm, provigjone të mjaftueshme për të mbuluar përgjegjësitë e marra në sigurim, apo detyrimet e tjera. Rritja e kapitalit minimal në nivelin e 3 milionë Eurove në një klimë ekonomike të favorshme

përbën një garanci për të rritur e zhvilluar tregun sipas parametrave dhe standardeve të pranuar ndërkombëtarisht.

- Gjatë 2007, u realizuan investimet e para të huaja në shoqëritë private të sigurimeve në Shqipëri. Uniqa Group Austria, TBIH Financial Services N.V. e mbështetur nga Vienna Insurance Group dhe Grupi ASPIS, kanë tashmë zotërimi influencuese në shoqëritë Shqiptare të sigurimeve. Privatizimi i plotë i INSIG-ut është në proces dhe tregje prestigjioze kanë shprehur interesin e tyre në këtë drejtim.

- Rritja vjetore ishte 30% në 2007 dhe është me interes të përmendet që sigurimet vullnetare të jetës dhe jo –jetës u rritën me ritme të kënaqshme.

- Totali i aktiveve të tregut të sigurimeve u rrit me rreth 17%, ndërsa aktivet likuide të strukturuar në depozita me afat dhe bono thesari u rritën me 45%. Kjo tregon për një tendencë pozitive të investimeve likuide në sektorin e sigurimeve.

- Aftësia paguese u rrit me 35% krahasuar me 2006.

- Procesi i mbikëqyrjes u pasurua me elementë të mbikëqyrjes me bazë riskun, siç ishte përfshirja në analizë e testeve dhe raporteve IRIS.

- Për herë të parë u vu re strukturimi në formën e grupit, çfarë kërkoi edhe përshtatje në sistemin e rregullimit dhe mbikëqyrjes.

Pati përpjekje të konsiderueshme për të promovuar produkte të sigurimeve që ndihmojnë zhvillimin e shëndoshë të bizneseve të tjera dhe janë jetësore për mbrojtjen e interesave të publikut. Së shpejti pritet një rritje thelbësore në portofole të veçantë të sigurimeve që mbulojnë përgjegjësinë e operatorëve të karburanteve, ndërtesave, hoteleve, minierave, bujqësisë, etj. Puna tashmë ka nisur në hartimin e programeve të sigurimit për mbrojtjen nga katastrofat natyrore në shkallë vendi.

Reforma e nisur nga Qeveria në sigurimet e shëndetit do të nxitë penetrimin e sigurimeve me një gamë produktesh të shëndetit. Hapi i parë i rimbursimit të medikamenteve pritet të shoqërohet së shpejti me rimbursimin e shërbimeve të tjera parësore dhe dytësore.

Zhvillimet e nisura në 2007 do të nxitin më tej edhe nga prania e investitorëve të huaj prestigjiozë, që pritet të ndikojë në një përjasje bashkëkohore të shoqëruar me praktika të mirë orientuara të biznesit.

II. Si investojnë shqiptarët për të ardhmen e tyre? – Pensionet

Le të shqyrtojmë pyetjen: A qëndron shprehja se një komb plakët para se të pasurohet në rastin e Shqipërisë?

Përgjigja lidhet ngushtë me strukturën demografike dhe zhvillimin ekonomik të një vendi. Bazuar në shifra, është e qartë se kushtet në Shqipëri janë shumë më të favorshme se në vende të tjera të Europës. Siç dihet, Shqipëria ka një popullsi të re (me moshë mesatare 32 vjeç), më shumë se 2 milionë banorë janë midis moshave 15 dhe 65. Treguesi tjetër, ai i rritjes ekonomike konsiderohet shumë i qëndrueshëm gjatë viteve të kaluara, në nivelin e rritjes vjetore midis 5% dhe 7%.

Në këtë këndvështrim, fuqia punëtore e aftë për të zhvilluar ekonominë e vendit dhe për të gjeneruar të ardhura personale, mund të konsiderohet si një forcë e madhe që krijon të mira materiale për të tashmen dhe kursime për të ardhmen. Për të nxitur kursimet për të ardhmen, nevojiten edhe lehtësira fiskale. Qeveria mund të inkurajojë banorët të kursejnë vullnetarisht pjesë të të ardhurave të tyre për t'i përdorur në të ardhmen. Punëdhënësit duhet të bëhen pjesë e kursimeve në grup, në rast se lehtësirat fiskale janë të konsiderueshme dhe mund të ndikojnë në menaxhimin më të mirë të bizneseve të tyre.



Aktualisht ka vetëm tre shoqëri të pensioneve private suplementare në treg dhe kontributi total llogaritet në 32 milionë lekë për vitin 2007.

Mosha e re e popullsisë dhe rritja e ekonomisë japin shpresa të mëdha të zhvillimit të tregut të pensioneve vullnetare në Shqipëri.

III. Letrat me vlerë

Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë po bëhet gjithnjë e më tërheqës për investitorët vendas e të huaj. Nga pikëpamja e riskut, stabiliteti makroekonomik, përfshirë këtu një kurs të stabilizuar të këmbimit të monedhës, mundëson një kombinim të favorshëm të kthimit me riskun.

Zotërimet e individëve dhe institucioneve jo – bankare në 2007 ishin vetëm 5% e 3 bilionë Eurove të emetimeve totale. Gama e maturiteteve është zgjeruar gjatë vitit 2007, përfshirë këtu emetimet për herë të parë të bonove 2 dhe 5 vjeçare, ndërsa emetimet e bonove 7 vjeçare kanë nisur tashmë. Emetimet vendase janë në pjesën më të madhe në Lek, por ndërkohë Ministria e Financave ka emetuar letra me vlerë në Euro me kohëzgjatje 2 vjeçare dhe po sheh mundësinë e bonove Europiane në tregjet ndërkombëtare të kapitalit brenda vitit 2009.

Infrastruktura e tregtimit është përmirësuar. Investitorët mund të hyjnë në ankandet e tregut parësor nëpërmjet ndërmjetësve (bankave). Përmirësimi i marrëveshjeve të pastrimit dhe rregullimit pritet të rritë vëllimin e tregut dytësor në të ardhmen.

IV. Elementë të rregullimit dhe mbikëqyrjes

Ngritja e AMF-së sipas modeleve më të mira ndërkombëtare, përbën një sinjal të qartë të konsolidimit dhe standardizimit të regjimit

rregullativ dhe mbikëqyrës.

Mbikëqyrja nuk nënkupton konfrontimin midis palëve por udhëheq drejt rregullit universal të ligjit.

Përprojekjet e kryera nga AMF, në përmirësimin e rregullimit dhe mbikëqyrjes, janë kombinuar më së miri me përfshirjen e platformës së integruar informatike që përfshin sisteme të ndryshme si qendra e të dhënave të sigurimeve motorrike, sistemi i raportimit elektronik, sistemi GSRM, etj.

V. Përse të investoni në tregjet financiare jo – bankare në Shqipëri?

Stabilitet politik

- Integrimi Euro-Atlantik është synimi kryesor i vendit.

Pamje pozitive e ekonomisë

- Rritje e PBB-së dhe kontroll mbi inflacionin.
- Investime publike dhe infrastrukturore.
- Zgjerim i sistemit bankar.
- Pritshmëri optimiste mbi zhvillimet në sektorë të rëndësishëm si energjia, ndërtimi, turizmi, minierat, etj.
- Përmirësim i ambientit të biznesit dhe lehtësira fiskale.

Rregullim dhe mbikëqyrje më e mirë

- AMF e ngritur sipas modeleve më të mira të integritit të mbikëqyrjes së sektorit financiar jo – bankar.
- Përshtatje e rregullave me standardet ndërkombëtare dhe direktivat Europiane me synim zhvillimin e shëndoshë të sektorit.
- Përfshirje e elementëve të mbikëqyrjes me bazë riskun, mbështetur nga platforma informatike.

Rritje e eksperiencës dhe ekspertizës

- Numër në rritje i ekspertëve financiarë në vend.

- Motivim i profesioneve të veçanta, përfshirë aktuarët, kontabilistët, trajtuesit e dëmeve, etj.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

I. “Gjeografia e Sigurimeve 2007”, publikim i ri i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

“Gjeografia e sigurimeve 2007” është një publikim statistikor, i cili realizohet për herë të parë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Në thelb të këtij publikimi përfshihet informacioni mbi shpërndarjen e primeve dhe produkteve të sigurimit sipas prefekturave, i shoqëruar me informacion mbi dendësinë e sigurimeve (pra primi i sigurimit për frymë sipas prefekturave).


Infrastruktura ekzistuese për të dhënat e vitit 2007, si dhe mungesa e një baze të mirëfilltë të dhënash, kanë qenë dhe sfidat kryesore në finalizimin e këtij produkti. Si publikim i parë në llojin e vet, pavarësisht nga përafrimi i vlerave të disa produkteve për zona të caktuara, “Gjeografia e Sigurimeve 2007” tenton të ndërtojë një bazë të dhënash të munguar, por tepër të nevojshme për tregun e sigurimeve në tërësi. AMF konfirmon që me ngritjen e sistemit online të shitjeve për sigurimin e detyrueshëm motorrik, problemi i të dhënave të strukturuar sipas zonave gjeografike për sigurimin e detyrueshëm motorrik eliminohet për vitin 2008.

Një strukturim i tillë i informacionit bën të mundur analizimin më të mirë të tregut të sigurimeve sipas zonave gjeografike, duke i ardhur në ndihmë mbikëqyrjes në lidhje me

evidentimin e përqendrimit të tregut, vetë shoqërive si dhe studuesve të pavarur. Në një këndvështrim afatmesëm, sistemimi i të dhënave në këtë formë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i raportimit nga operatorët në tregun e sigurimeve, mund t'i hapë rrugën publikimeve më komplekse të strukturuar jo vetëm për qëllime informative, por edhe për analiza të mirëfillta të shpërndarjes së rrisqeve, tarifimit të produkteve dhe mbulimeve nga katastrofat sipas zonave gjeografike. Ky përmirësim do të mbështetet nga një sistem elektronik raportimi dhe përpunimi të të dhënave, për të cilin AMF është duke punuar.

Duke i hedhur një vështrim shpërndarjes gjeografike të sigurimeve, të bie në sy një përqëndrim i tregut të sigurimeve në Prefekturat e mëdha. (në këtë publikim nuk është përfshirë veprimtaria e risigurimeve)

Shpërndarja gjeografike e primit të shkruar bruto




Një tregues i rëndësishëm i tregut të sigurimeve është primi për frymë, i cili për vitin 2007 ishte rreth 1,877 lekë për frymë, me një rritje prej 446 lekë krahasuar me një vit më parë.

Përsa i përket primit për frymë sipas Prefekturave, prefektura e Tiranës me 4,034 lekë për frymë zë vendin e parë e pasuar nga prefektura Gjirokastrë me 2,219 lekë për frymë dhe më tej Durrësi dhe Vlora, përkatësisht me 2,107 lekë për frymë dhe 1,941 lekë për frymë.

Një renditje e tillë ku Gjirokastra renditet e dyta, shpjegohet me faktin se këtu popullsia nuk ka ritme rritje si në prefekturat e Shqipërisë qendrore dhe bregdetare dhe se banorët e kësaj prefekturë nuk shpenzojnë më shumë për produktet e sigurimit, por si një

prefekturë kufitare, mjetet që kalojnë drejt Greqisë blejnë produktin e Kartonit Jeshil. Prefektura të mëdha si Durrësi dhe Vlora janë normale në këtë renditje.

Primi per fryme sipas prefekturave(ne lek)




Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës zë 93.07% të tregut të sigurimeve.


Duke analizuar sigurimet e jo-jetës shohim se Sigurimi Motorrik zë 76.95% dhe Sigurimi Jo Motorrik zë 23.05%.

Shpërndarja gjeografike e primit te shkruar bruto Jo-Jeta



Sigurimi Motorrik


Ndarja e produkteve të Sigurimit Motorrik sipas prefekturave



Peshën më të madhe në prime të shkruara bruto, në sigurimin motorrik, e zë Prefektura Tiranë me 42.97% e më pas Durrësi me 13.58%, Fieri me 7.61% dhe Vlora me 7.27%, kjo e shpjeguar me faktin e përqendrimit më të madh të popullsisë në këto prefektura, për prefekturat e Durrësit dhe Vlorës duke qenë dhe prefektura bregdetare.

Sigurimi Jo Motorrik

Tregu i produkteve Jo Motorrike të sigurimit mbetet ende në nivele të ulta, duke patur parasysh këtu potencialet e mëdha të pashfrytëzuara që ka vendi.




Zhvillimi i tij është i lidhur ngushtë me nivelin ekonomik, por edhe me shkallën e edukimit dhe besimin e konsumatorëve ndaj operatorëve të tregut.

Të bie në sy në Sigurimin Jo Motorrik rreth 80% të primeve të shkruara bruto e zë Prefektura Tiranë. Pavarësisht përqendrimit të bizneseve dhe Bankave në Tiranë, shpërndarja gjeografike e sigurimeve Jo Motorrike mbart deviacione, përsa i përket prefekturës ku ndodhet përgjegjësia e siguruar dhe primit të shkruar të raportuar, ku në të shumtën e rasteve lidhja e kontratave të sigurimit bëhet në prefekturën e Tiranës, ku ndodhen dhe Drejtoritë e Përgjithshme të Shoqërive të sigurimit.

Sigurimi i Jetës

Edhe në produktet e Jetës shihet se Prefektura Tiranë zë rreth 80% të tregut.

Shpërndarja gjeografike e primit të shkruar bruto Jeta



Siç shihet dhe në grafik, në prefekturat e mëdha ku është përqendruar biznesi dhe bankat, pesha specifike e produkteve të Jetës është më e larta. Peshën më të madhe, prej rreth 76% në të ardhurat e sigurimit të Jetës, e zë produkti "Jetë Debitori". Ky produkt i sigurimit është kërkesë e Bankave të nivelit të dytë për ofrimin e kredive individëve dhe personave juridikë.

II. Vështrim mbi tregun e sigurimeve për periudhën janar-prill 2008

Në periudhën janar – prill 2008, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 2,054,344 mijë lekë, përkundrejt 1,790,578 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Tregu i sigurimeve shënoi një rritje në masën 14.73 % nga viti i kaluar, ku 77.36 % e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo-Jetës, ndërsa 22.64 % tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, u shënuar një rritje në masën 61.43 % të sigurimeve të Jetës dhe 12.05 % të sigurimeve të Jo – Jetës.

Në periudhën janar – prill 2008, volumi i primeve nga sigurimi i detyrueshëm u rrit në masën 4.47 %, ndërsa volumi i primeve të sigurimit vullnetar të Jo – Jetës u rrit në masën 31.87 %.

Në periudhën janar – prill 2008 u lidhën 178,124 kontrata sigurimi përkundrejt 152,712 kontrata të lidhura në të njëjtën periudhë të vitit 2007. Numri i kontratave të sigurimit të Jo - Jetës kapi vlerën 161,653 nga 142,378 që i takojnë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Portofoli MTPL shënoi rritjen më të madhe të numrit të kontratave me 6,740 kontrata ose në masën 9.65 % më shumë se janar – prill 2007. Vlen të përmendet rritja në masën 59.39 % e numrit të kontratave të sigurimit të jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kapi vlerën 16,471 nga të cilat sigurimi “Jeta dhe Shëndeti në udhëtim” pati një rritje prej 2,229 kontrata ose (71.31 %), duke shënuar dhe dinamikën më të lartë në rritjen e kontratave të sigurimit të Jetës.


Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - prill 2008 ishte rreth

403,622 mijë lekë, ose 21.48 % më pak se në janar - prill të vitit 2007. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto u përket sigurimeve motorrike me 339,171 mijë lekë, apo 84.45 % të totalit. Kjo ulje në dëmet e paguara bruto ndihet në portofolin "Kartoni Jeshil" ku kemi një ulje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me rreth 59.83 % dhe ulje të numrit të dëmeve të paguara me rreth 40.00 % krahasuar me 4 mujorin e parë të vitit 2007.


Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar - prill (2007 – 2008)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
Periudha janar - prill	2007	2008
A) Sigurim i Jetës	97,230	156,956
B) Sigurim i Jo - Jetës	1,693,348	1,897,387
nga këto		
a) Sigurimi Detyrueshëm	1,224,923	1,279,680
b) Sigurimi Vullnetar	468,424	617,708
TOTAL	1,790,578	2,054,344

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën janar – prill 2008 (Jeta dhe Jo - Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit për periudhën janar –prill 2008 (Jo - Jeta)



Ngjarje dhe zhvillime të tjera

I. Takim i Kryetares së AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni, me përfaqësuesit e lartë të Autoritetit Qëndror Bankar të Kosovës

Në datën 6 Maj 2008, një delegacion i nivelit të lartë të Autoritetit Qëndror Bankar të Kosovës (AQBK), i përbërë nga Z. Gazmend Luboteni, Kryetar i Bordit, Z. Hashim Rexhepi, Drejtor i Përgjithshëm dhe Z. Agron Dida, Inspektor i Përgjithshëm, pati një takim pune me Zj. Elisabeta Gjoni, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe nënkryetarët, Ermela Guxholli e Keler Gjika. Ky takim u zhvillua në kuadrin e një vizite dy ditore në Tiranë të përfaqësuesve të AQBK-së, menjëherë pas marrjes prej tyre të funksioneve më të larta drejtuese të këtij institucioni.

Takimi vuri theksin në rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit të dy institucioneve për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorëve financiarë jo - bankarë, si domosdoshmëri në ruajtjen e stabilitetit financiar të të dy vendeve dhe të rajonit në përgjithësi. Përjasja e rregullave me direktivat Europiane dhe vendosja e standardeve ndërkombëtare në të dy vendet do të mbështetet nga bashkëpunimi dhe shkëmbimi i eksperiencës së të dy rregullatorëve.

Vend të veçantë në diskutime patën: trajtimi i problemeve të sigurimeve të detyrueshme motorrike dhe nevoja për ndryshime në arkitekturën e tyre, përfshirja e elementëve të mbikëqyrjes me bazë rrezikun në mbikëqyrjen e sigurimeve dhe pensioneve, kryerja e inspektimeve të përbashkëta, zhvillimi i tregjeve të letrave me vlerë, etj.

Në përfundim të takimit, përfaqësuesit e të dy institucioneve u angazhuan për forcimin e frymës së bashkëpunimit midis dy institucioneve nëpërmjet takimeve të tjera të cilat duhet të jenë të shpeshta. Në këtë kuadër, përfaqësuesit e lartë të AQBK-së ftuan Zj. Elisabeta Gjoni për një vizitë zyrtare në Prishtinë.

II. Mbi pjesëmarrjen në konferencën e 33-të vjetore të IOSCO-s

Gjatë periudhës 26-29 maj 2008, në Paris, Francë, u zhvillua konferenca e 33-të vjetore e IOSCO-s. Në të morën pjesë rreth 750 delegatë nga rregullatorë të letrave me vlerë nga mbarë bota dhe komuniteti ndërkombëtar financiar. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua nga Kryetarja, Zj. Elisabeta Gjoni dhe Nënkryetari, Z. Keler Gjika.

Konferenca vjetore përbën evenimentin më të rëndësishëm të vitit në lidhje me rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të kapitalit. Konferenca morri një rëndësi të veçantë duke patur parasysh situatën jo-pozitive në tregjet ndërkombëtare financiare, e stimuluar nga kriza e normave të interesit "sub-prime" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Parësore mbetet rritja e bashkëpunimit mes rregullatorëve për të identifikuar, rregulluar dhe parandaluar transferimin jo të përshtatshëm të riskut përmes mekanizmave të tregut.

Konferenca u përshëndet nga Zj. Christine Lagarde, Ministre e Ekonomisë, Industrisë dhe Punës së Francës, e cila vlerësoi rolin e rregullatorëve të Letrave me Vlerë në bashkëpunimin ndërkombëtar të rregullatorëve dhe shkëmbimin e informacionit.

Gjatë zhvillimit të konferencës disa nga çështjet më të rëndësishme që u trajtuan dhe me relevancë për Autoritetin Shqiptar të Mbikëqyrjes Financiare, kishin të bënin me :

o Memorandumin shumëpalësh të mirëkuptimit të IOSCO-s, ku u theksua:

Janë 48 anëtarë të IOSCO-s që kanë nënshkruar MMOU-në.

U theksua drejtimi i mirë i Komitetit të Tregjeve në Zhvillim, dhe u fol për Seminarin Rajonal për Bashkëpunimin dhe Shkëmbimin e Informacionit që u organizua në bashkëpunim me Autoritetin Polak, qëllimi i të cilit ndër të tjera ishte inkurajimi dhe nxitja e vendeve që nuk kanë nënshkruar MOU me programe të veçanta asistence, që drejtohen nga Sekretariati i Përgjithshëm i IOSCO-s. Kjo do të jetë edhe një nga qëllimet kyçe të punës së organizatës për 2-vitet e ardhshme. Shqipëria është në procesin e plotësimit të hapave të nevojshëm për plotësimin e kushteve për nënshkrimin e MMOU-së. Në këtë proces, AMF është duke u asistuar nga Autoriteti Mbikëqyrës i Polonisë.

o Implementimin e parimeve dhe objektivave të IOSCO-s.

Këto parime dhe objektiva janë nënshkruar që në 1998, dhe qëllimi i tyre ishte të inkurajonin vendet të përmirësonin kualitetin e mbikëqyrjes në tregjet e letrave me vlerë. Në vazhdimësi, në 2005 u krijua Programi i Implementimit, me qëllim ofrimin e asistencës për vendet anëtare për adoptimin dhe zbatimin e Parimeve të IOSCO-s. IOSCO është duke kërkuar mundësi për të siguruar më shumë asistencë teknike të vlefshme për anëtarët e IOSCO-s për të përshpejtuar procesin e implementimit.

o Iniciativat për rritjen e standardeve dhe bashkëpunimit në kuadër të mbikëqyrjes së

aktiviteve “cross-border”.

Qëllimi kryesor është të instalohen mekanizma të përshtatshëm për të asistuar çdo vend të bëjë përmirësime reale ligjore që të jenë në gjendje të ofrojnë bashkëpunimin në lidhje me shkëmbimin e informacionit si dhe zhvillimin e dialogut midis Komunitetit të Shërbimit Financiar. Ky dialog është esencial për krijimin e standardeve që i përgjigjen sfidave të kohës, si dhe rrisqeve për një mbikëqyrje sa më të mirë.

Gjatë konferencës u zhvilluan edhe zgjedhje për komitete të ndryshme të IOSCO-s.

Z. Christopher Cox, Kryetar i Komisionit të Letrave me Vlerë, USA, u zgjodh Kryetar i Komitetit Teknik të IOSCO-s.

- Z. Guillermo Larrain, Autoriteti Mbikëqyrës Uruguajan, u zgjodh Kryetar i Komitetit të Tregjeve në Zhvillim dhe
- Zj. Zarinah Anwar, Nënkryetarë.

Në postet drejtuese të Komitetit Ekzekutiv u zgjodhën :

- Znj. Jane Diplock, Kryetare e Autoritetit Mbikëqyrës i Zelandës së Re, u zgjodh Kryetare e Komitetit Ekzekutiv.
- Z. Shang Fulin, nga Autoriteti Mbikëqyrës i Kinës, u zgjodh Zëvendëskryetar. Gjithashtu, në Konferencë u bënë pranime të reja në IOSCO, si dhe u përcaktua kalendari i Konferencës Vjetore të ardhshme.

Mbledhja e ardhshme vjetore e IOSCO-s do të mbahet në Tel-Aviv, Israel në 8-11 Qershor, 2009.

III. Organizohet misioni TAIEX për kuadrin ligjor të pensioneve private vullnetare

Në datat 5 – 7 maj 2008, në ambientet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, u organizua misioni i ekspertëve TAIEX, përfaqësuar nga z. Slawomir Solarz, ekspert me përvojë të gjatë në fushën e pensioneve, aktualisht Këshilltar i Kryetarit pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë. Misioni pati si objekt asistencën në rishikimin e kuadrit ligjor në fushën e pensioneve suplementare private. Gjatë kohëzgjatjes së misionit u trajtuan çështje të rëndësishme mbi eksperiencën e vendeve si Polonia dhe Bullgaria në kuadër të reformës në sistemin e pensioneve dhe hartimit të kuadrit të nevojshëm legjislativ për kolonën e tretë.

Qëllimi i këtij misioni ishte:

- a) Këshillimi në lidhje me ndërtimin e strukturës së ligjit të pensioneve private vullnetare.
- b) Parimet bazë që duhet të përmbajë ligji i kolonës së tretë, duke marrë parasysh faktin që Shqipëria nuk ka ende bazë ligjore për kolonën e dytë.

Misioni u hap me një prezantim të Zj. Enkelejda Shehi, Drejtore e Departamentit të Kërkim TI dhe Statistikës, lidhur me situatën aktuale të sistemit të pensioneve në Shqipëri, përfshirë skemën e detyrueshme dhe atë vullnetare.

Takimi vijoi me paraqitjen nga ana e ekspertit të eksperiencës polake në lidhje me situatën aktuale legjislative në fushën e pensioneve të detyrueshme dhe vullnetare, rregullave në fushën e licencimit dhe të mbikëqyrjes së fondeve, përfshirë rolin e Autoritetit në

mbikëqyrjen e kolonës së tretë.

Gjatë këtij misioni u analizua skema e kolonës së tretë në Poloni dhe u zhvilluan diskutime rreth një skeme të mundshme që kolona e tretë mund të ketë në Shqipëri, duke marrë parasysh të gjitha specifikat dhe situatën aktuale të këtij tregu. Një vend të rëndësishëm zuri analizimi i legjislacionit polak në fushën e pensioneve, parë në këndvështrimin e përfuturit të elementëve të mundshëm që mund të gjejnë zbatim dhe në kushtet e Shqipërisë. Më tej u diskutuan pika të veçanta, të cilat duhen mbajtur parasysh gjatë hartimit të ligjit të ri, si p.sh roli i bankës depozituese, i shoqërisë menaxhuese të fondit të pensioneve, mënyrat e investimit të aktiveve të fondit, etj.

Si rezultat i një diskutimi të gjatë midis ekspertit dhe përfaqësuesve të pranishëm të AMF, (pala përfaqësuese e AMF-së përbëhej nga E. Shehi, R. Guri, F. Musta, L. Lloji) misioni u mbyll me propozimin e një skeme të mundshme të kolonës së tretë në Shqipëri dhe të disa elementeve kyç që duhet të përmbajë ligji i ri.

IV. Pjesëmarrje në seminarin “Vështrim i përgjithshëm i çështjeve të sektorit financiar”

Në datat 28 prill - 2 maj, në Washington DC, Banka Botërore (WB) organizoi seminarin me temë “Vështrim i përgjithshëm i çështjeve të sektorit financiar”

Pjesëmarrësit në këtë seminar ishin nga më shumë se 20 vende të ndryshme të botës, nëpunës të bankave qendrore, ministrive të financave si dhe agjencive rregullatore financiare.

Ndër temat më të rëndësishme që u trajtuan në konferencë mund të veçojmë:

- Roli dhe përcaktuesit e zhvillimit të sektorit financiar.
- Menaxhimi i riskut modelet dhe aplikimet.
- Reforma në sistemin financiar. (FIRST)
- Mbikëqyrja dhe testi i stresit, koncepte dhe praktika.
- Basel II dhe implikimet e tij për vendet në zhvillim.
- Anatomia e të shkuarës dhe kriza e ardhshme financiare.
- Sfidat zhvilluese lidhur me sistemin e pagesave.
- Sfidat për zhvillimin e tregut të sigurimeve.
- Sfidat për zhvillimin e sistemit të pensioneve.
- Qeverisja dhe privatizimi i bankave.
- Raste studimore.

Temat e paraqitura u trajtuan me shumë profesionalizëm dhe pati mjaft diskutime dhe pyetje rreth tyre. Identifikimi i çështjeve kritike bashkëkohore, analiza e problemeve, si dhe ndarja e eksperiencës me pjesëmarrësit, e bëri seminarin mjaft të vlefshëm dhe efektiv.

Në fund të seminarit u shpërndanë certifikata për të gjithë të pranishmit.

Për këtë numër punuan:

K. Gjika, E. Shehi, R. Guri, V. Theodhori,
E. Kokona, R. Eltari

